

PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM
DHE ZHVILLIM

UDHËZUES PRAKTIK
PËR TË PARANDALUAR
ABUZIMIN E MUNDSHËM
TË ORGANIZATAVE
JO-FITIMPRURËSE
(OJF)
PËR PASTRIMIN E
PARAVE DHE FINANCIMIN
E TERRORIZMIT

2023

Ky publikim u përgatit nga *Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim me mbështetjen e Human Security Collective.*

Ky publikim u përgatit me mbështetjen e *Programit Global "Lufta kundër Qarkullimit të Paligjshëm të Parasë"*, zbatuar nga *GIZ* dhe mbështetur financiarisht nga *Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik* dhe *Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme.*

Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e *GIZ*, *Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik*, apo të *Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze.*

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.
Tiranë, Shqipëri 2023



ABSTRAKT



Në vitin 1990, FATF[1] hartoi 40 rekomandime, si një nismë për të luftuar keqpërdorimin e sistemeve financiare nga personat që pastrojnë paratë e drogës, të cilat u rishikuan në vitin 1996, për të pasqyruar tendencat dhe teknikat në zhvillim të pastrimit të parave dhe për të zgjeruar fushën e tyre përtej pastrimit të parave nga droga. Në tetor 2001, FATF zgjeroi mandatin e saj për t'u marrë me çështjen e financimit të akteve terroriste dhe organizatave terroriste dhe krijoi Tetë Rekomandime Speciale (më vonë u zgjeruan në Nëntë) për Financimin e Terrorizmit, ndër të cilat Rekomandimi 8, i cili i hartua për të adresuar vulnerabilitetet specifike dhe kërcënimet e financimit të terrorizmit për OJF-të, si më poshtë:

Rekomandimi 8: Organizatat JoFitimprurëse

Vendet duhet të rishikojnë përshtatshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me organizatat jofitimprurëse, të cilat vendi i ka identifikuar si të cënueshme nga abuzimi i financimit të terrorizmit. Vendet duhet të zbatojnë masa të përqendruara dhe proporcionale, në përputhje me qasjen e bazuar në rrezik, ndaj organizatave të tilla jofitimprurëse për t'i mbrojtur ato nga abuzimi i financimit terrorist, duke përfshirë:

- (a) organizatat terroriste që paraqiten si subjekte legjitime;*
- (b) për të shfrytëzuar entitete legjitime si mjete për financimin e terrorizmit, duke përfshirë edhe qëllimin për t'i shpëtuar masave të ngrirjes së asetëve; dhe*
- (c) për të fshehur ose errësuar diversionin klandestin të fondeve të destinuara për qëllime legjitime për organizatat terroriste.*

Në seancën plenare të FATF në qershor 2022, u ra dakord të konsiderohej rishikimi i Rekomandimit 8, për të adresuar problemet e mbi-aplikimit të masave parandaluese për sektorin e OJF-ve në disa shtete, duke njohur ndikimin negativ që kjo mund të ketë në aktivitetet legjitime të OJF-ve. Draft-ndryshimet e përgatitura nga Ekipi i Projektit i ngritur nga FATF u shpallën për konsultim publik në faqen e internetit të FATF[2].

Rekomandimet e FATF janë miratuar nga mbi 180 vende dhe njihen botërisht si standardi ndërkombëtar për luftën kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit (PPP/KFT).

Zbatimi i rekomandimeve të FATF në Shqipëri vlerësohet nga MONEYVAL – Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, një strukturë e përhershme e Këshillit të Evropës që ka për detyrë të vlerësojë pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e

[1] Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF), një organ i pavarur ndërqeveritar që zhvillon dhe promovon politika për mbrojtjen e sistemit financiar global kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Rekomandimet e FATF janë njohur si standardet globale kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit.

[2] <https://www.fatf-gafi.org/en/publications/Fatfrecommendations/R8-public-consultation-jun23.html>

parave dhe financimin e terrorizmit dhe efektivitetin e zbatimit të tyre, si dhe për t'u dhënë rekomandime autoriteteve kombëtare në lidhje me përmirësimet e nevojshme në sistemet e tyre[3].

Në vitin 2022, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe me mbështetjen e GIZ - Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar, përgatiti Metodologjinë e Vlerësimit të Rrezikut të OJF-ve ndaj Financimit të Terrorizmit në Shqipëri[4]. I kryer nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës me përfaqësues nga institucionet shtetërore përgjegjëse për regjistrimin, supervizimin dhe raportimin e OJF-ve, autoritetet ligjzbatuese, dhe OJF-të, në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet e FATF, metodologjia analizon karakteristikat dhe kategoritë e OJF-ve potencialisht në rrezik për t'u abuzuar për financim të terrorizmit dhe natyra e kërcënimeve të financimit të financimit për sektorin e OJF-ve. Si përfundim, nga vlerësimi rezultoi se nuk ka prova përfundimtare të abuzimit të OJF-ve për financim të terrorizmit, dhe se niveli i rrezikut të qenësishët të sektorit të OJF-ve për të përdorur për financim të terrorizmit është **I ULËT**.

[3] <https://www.coe.int/en/web/moneyval/moneyval-brief>

[4] <https://partnersalbania.org/ep-content/uploads/2023/01/Metodologjia-vleresimit-te-rrezikut-te-ojfe.pdf>

TABELA E PËRMBAJTJES

V

REGULLORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË LIDHUR ME
OJF.....17

IV

LIGJI PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE
FINANCIMIT TË TERRORIZMIT.....15

III

DETYRIME TË TJERA PËRKATËSE.....14

II

REGJISTRIMI I PRONARËVE PËRFITUES.....13

I

REGJISTRIMI I OJF-ve.....11

1

PJESA E PARË.....10

Legjislacioni për Parandalimin e Pastrimit të Parave (PPP) dhe Kundër
Financimit të Terrorizmit (KFT).

HYRJE.....07

2

PJESA E DYTË.....33

Raste studimore mbi rrezikun e abuzimit terrorist në sektorin e OJF-ve.

IX

**VEPRAT PENALE të posaçme lidhur me Pastrimin e Parave
dhe Financimin e Terrorizimit.....28**

VIII

**SHKELJET DHE SANKSIONET
ADMINISTRATIVE.....23**

VII

**MODELE TË DYSHIMTA TË PËRDORURA SI STANDARDDE
NDËRKOMBËTARE / KOMBËTARE ORIENTUESE PËR
ZBULIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE TË FINANCIMIT TË
TERRORIZMIT.....21**

VI

**INDIKATORËT E RISKUT TË FINANCIMIT TË TERRORIZMIT NË
SEKTORIN OJF.....19**



HYRJE



Në këtë broshurë synojmë të sjellim në vëmendjen tuaj parandalimin e abuzimit dhe të mundësisë së abuzimit të OJF-ve për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Broshura është e shkruar në mënyrë të thjeshtë për t'u përdorur pa ndihmë apo shërbim të specializuar juridik.

Broshura është e hartuar në dy pjesë:

Pjesa e parë: Legjislacioni për Parandalimin e Pastrimit të Parave (PPP) dhe Kundër Financimit të Terrorizmit (KFT)

Në këtë pjesë përmenden dhe bëhen referenca në legjislacionin përkatës kryesor të zbatueshëm për OJF-të në mënyrë që organizatat të orientohen vetë për zbatimin e ligjit ose zgjidhjen e rasteve praktike përkatëse. Ligji nr. 80/2021 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse” është publikuar në fletoren zyrtare numër 121, duke bërë më të lehtë aksesin e organizatave në këtë ligj. Në rast të veçantë, kur OJF-ja përballlet me probleme të konstatuara nga organet tatimore apo struktura të tjera të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), për zbatimin e legjislacionit përkatës dhe zgjidhjet ligjore përkatëse, mund të nevojitet edhe shërbimi i një avokati.

Zbatimi i legjislacionit përkatës në fuqi mundëson që OJF-ja, që nga çasti i themelimit dhe regjistrimit në Regjistrin e OJF-ve, të parandalojë përfshirjen në pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Për këtë arsye, kjo broshurë përmban dispozita ligjore që përkojnë me çështje ligjore të krijimit të OJF-ve, me veprimtarinë në vazhdimësi të OJF-ve, përfshirë atë financiare dhe operacionale, me çështje të përditësimit të të dhënave në Regjistrimin e OJF-ve, dhe deri në mbylljen e aktivitetit dhe çrregjistrimin e OJF-ve. Vëmendje të veçantë marrin në këtë broshurë edhe disa çështje ligjore në lidhje me regjistrimin e pronarëve përfitues. Për lehtësi të OJF-ve, dispozitat ligjore të përmendura apo cituara në këtë broshurë shoqërohen edhe me numrin dhe datën e Fletores Zyrtare (ose FZ) të Republikës së Shqipërisë ku është botuar legjislacioni përkatës.

Në veçanti, në këtë broshurë, duke bërë të ditura për OJF-të faktorët e riskut që përdorin organet tatimore apo struktura të DPPPP në identifikimin e çështjeve që kanë të bëjnë me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit për OJF-të, jepen kuptime dhe shpjegime të cilat orientojnë OJF-të si të përgatisin dhe të mbajnë dokumentacionin në lidhje me financimet që marrin nga donatorë të ndryshëm, si dhe të përmirësojnë aspekte operacionale në funksion të mënjanimit të abuzimit apo përfshirjes së OJF-ve në pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

OJF-të duhet të jenë të ndërgjegjësuar jo vetëm për shkeljet administrative dhe sanksionet përkatëse, por edhe për veprat penale të posaçme lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe përgjegjësinë penale të tyre si persona juridike, por edhe për individët që ushtrojnë detyra në organet vendimmarrëse dhe ekzekutive të OJF-ve. Për këtë arsye, kjo broshurë përmban edhe informacione në lidhje me shkeljet administrative dhe veprat penale përkatëse, si dhe me sanksionet e dënimit përkatëse.

Falenderojmë Avokaten Adriana Shehi për kontributin e saj në përgatitjen e kësaj pjese të dokumentit.

Pjesa e dytë: Raste studimore mbi rrezikun e abuzimit terrorist në sektorin e OJF-ve

Në këtë pjesë prezantohen disa raste studimore të përkthyer nga Raporti i FATF “Rreziku i abuzimit terrorist në Organizatat Jo-Fitimprurëse”, Qershor 2014[5]. Nëpërmjet 102 rasteve studimore të paraqitura nga shtetet anëtare të FATF apo të hartuara nga burimet e hapura të informacionit, si dhe nëpërmjet hulumtimit mbi mjedisin kërcënues, raporti synon kuptimin mbi kërcënimin terrorist në sektorin e OJF-ve. Nga analiza e rasteve studimore rezultuan disa gjetje, të cilat janë përmbledhur në raport si më poshtë:

Gjetja kryesore 1: Sektori i OJF-ve ka vulnerabilitete të ndërlidhura, dhe subjektet terroriste synojnë të shfrytëzojnë më shumë se një vulnerabilitet. Nga rastet e analizuar në raport, devijimi i fondeve të OJF-ve nga subjektet terroriste rezultoi se ishte metoda dominante e abuzimit. Gjithsesi, forma të tjera të abuzimit jo-financiar, si abuzimi i programeve, apo mbështetja për rekrutim, janë gjithashtu të pranishme.

Gjetja kryesore 2: OJF-të më shumë të rrezikuara duket të jenë ato që përfshihen në aktivitete ‘shërbimi’, dhe që veprojnë në afërsi me një rrezik aktiv terrorist. Kjo mund t’i referohet OJF-ve që veprojnë në një zonë konflikti ku ekziston një kërcënim aktiv terrorist, por mund të referohet edhe OJF-ve që veprojnë brenda vendit, por me një popullsi që është aktivisht e targetuar nga një lëvizje terroriste për mbështetje dhe maskim. Në të dy rastet, variabli kryesor i rrezikut nuk është gjeografia, por afërsia me një rrezik aktiv.

Gjetja kryesore 3: Për shkak të natyrës së kërcënimit dhe natyrës së rezultateve të reagimit të shtetit, rastet e një kërcënimi thelbësor janë një burim i rëndësishëm informacioni për analizën e tipologjive të rrezikut.

Gjetja kryesore 4: Përdorimi i shumë tipeve të informacionit nga aktorë të ndryshëm është një faktor i rëndësishëm në zbulimin e rasteve të abuzimit apo në identifikimin e rrezikut thelbësor.

Gjetja kryesore 5: Ndërprerja e abuzimit, apo zbutja e rrezikut thelbësor, është trajtuar nëpërmjet dënimeve të shumëllojshme përfshirë dhe jo vetëm ndjekjen penale. Dënimi administrativ, gjobat financiare dhe sanksionet financiare të targetuara luajnë një rol të rëndësishëm në ndërprerjen e abuzimit.

[5] <https://www.fatf-gafi.org/en/publications/Methodsand Trends/Risk-terrorist-abuse-non-profits.html>



PJESA E PARË

Legjislacioni për Parandalimin e Pastrimit të Parave (PPP) dhe Kundër Financimit të Terrorizmit (KFT)

I REGJISTRIMI I OJF-ve

Hapi i parë për një OJF, që të themelohet dhe të ekzistojë si person juridik në përputhje me legjislacionin shqiptar, është themelimi sipas Ligjit për OJF-të dhe, më pas, regjistrimi fillestar në Regjistrin Elektronik të organizatave jofitimprurëse (në këtë broshurë referuar si 'Regjistri Elektronik i OJF-ve'[6]). Sipas legjislacionit në fuqi, Regjistri i OJF-ve krijohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe administrohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OJF-të regjistrohen duke paraqitur një kërkesë regjistrimi (elektronikisht ose formë shkresore) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë[7]. Kërkesa e regjistrimit paraqitet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e themelimit të OJF-së[8]. Kërkesa për regjistrim paraqitet ose nga të gjithë themeluesit e OJF-së ose nga një person i autorizuar.

Të dhënat që paraqiten për regjistrimin e OJF-ve janë: emri, forma e organizimit, data e themelimit, të dhënat personale të personave që kanë themeluar OJF-në (kur themeluesi i OJF-së është një person juridik, ka detyrim për të paraqitur të dhëna, siç janë emri i personit juridik, forma juridike, NIPT, data e themelimit dhe regjistrimit, përfaqësuesi ligjor i subjektit apo personave që janë përgjegjës për përfaqësimin me të tretët, të dhënat elektronike), selia, qëllimi dhe veprimtaria e OJF-së, kohëzgjatja, të dhënat personale të individëve që bëjnë administrimin dhe përfaqësimin e OJF-së, vlera pasurore e fondit kur kemi themelimin e një fondacioni, personat që do të kenë të drejtën e nënshkrimit kur përfaqësojnë OJF-në me palë të treta[9].

Një kujdes i veçantë duhet të tregohet që të mënjanohet përdorimi i emrave të njëjtë apo të ngjashëm, emrave në trajtën e shquar apo shkurtimet përkatëse të shteteve, qyteteve, krahinave gjeografike, organizatave ndërkombëtare, fetare ose institucioneve të pushtetit qendror apo vendor, pa shtesa dalluese ose me emra që janë në kundërshtim me rendin ose me dispozitat urdhëruese të ligjit[10]. Mosplotësimi i këtyre kriterëve sjell mosregjistrimin e OJF-së në Regjistrin Elektronik të OJF-ve. E drejta për të regjistruar emrin njihet në bazë të parimit të përparësisë së paraqitjes së kërkesës për regjistrim në gjykatë.

Pas kryerjes së regjistrimit fillestar në Regjistrin Elektronik të OJF-ve, OJF-të janë të detyruara që të regjistrojnë çdo ndryshim që bëjnë në të dhënat e detyrueshme, si dhe në dokumentet shoqëruese që depozitohen në Regjistrin Elektronik të OJF-ve. Në rast ndryshimi të aktit të themelimit ose statutit, depozitohet edhe teksti i plotë i tyre, ky pasqyrohen ndryshimet e mëposhme[11].

OJF-të kanë të drejtë që me vullnetin dhe kërkesën e tyre të regjistrojnë në Regjistrin Elektronik të OJF-ve çdo të dhënë tjetër e cila ka lidhje me veprimtarinë e tyre. Përfshihen në këto të dhëna vullnetare: emërtimi / shenja dalluese të veprimtarisë, mënyrat e kontaktit, vendimet që marrin organet drejtuese të OJF dhe të dhëna të tjera që lidhen me veprimtarinë e tyre[12].

[6] Sipas deklaratës zyrtare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLGJ), Regjistri Elektronik i OJF-ve do të jetë funksional në Janar 2024.

[7] Neni 4 i ligjit nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", FZ 121, datë publikimi 02.08.2021.

[8] Neni 8 i ligjit nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", FZ 121, datë publikimi 02.08.2021.

[9] Neni 14 i ligjit nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", FZ 121, datë publikimi 02.08.2021.

[10] Neni 9 i ligjit nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", FZ 121, datë publikimi 02.08.2021.

[11] Neni 12/3 i ligjit nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", FZ 121, datë publikimi 02.08.2021.

[12] Neni 18 i ligjit nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", FZ 121, datë publikimi 02.08.2021.

Gjyqtari i seksionit tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë bën regjistrimin dhe çrregjistrimin e OJF-ve, ndërsa regjistrimet e tjera të detyrueshme apo vullnetare bëhen me vendim të Kancelarit.

Pasi janë kryer procedurat e regjistrimit, OJF-të pajisen me NIPT i cili është një numër unik i pandryshueshëm, i cili vendoset nga Gjykata dhe shërben për identifikimin e OJF-ve si persona të tatueshëm pranë autoriteteve tatimore, skemës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për autoritetet e inspektimit të marrëdhënieve të punës, si dhe për çdo qëllim tjetër statistikor ose identifikues[13].

OJF-të pajisen me certifikatë regjistrimi nga sekretaria e Regjistrimit Elektronik të OJF-ve, e cila lëshohet brenda afatit për regjistrimin fillestar duke mbajtur elementët identifikues të OJF-së[14].

Çregjistrimi i OJF-ve bëhet me vullnetin e lirë dhe iniciativën e OJF-së ose në bazë të një vendimi gjyqësor[15]. Pas momentit të çregjistrimit, OJF-të shënohen si “të çregjistruar” në Regjistrin Elektronik të OJF-ve dhe, për pasojë, humbasin personalitetin e tyre juridik[16].

Mosrespektimi i afateve për regjistrim dhe çregjistrim të OJF-ve dhe depozitim aktesh në Regjistrin Elektronik të OJF-ve dënohet me gjobë jo më të vogël se 30.000 (tridhjetë mijë) lekë. Kundër dënimit me gjobë, OJF-ja mund të paraqesë ankim në Gjykatën e Apelit[17].

Duke u bazuar në Ligjin nr. 8788/2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar[18], konkretisht, në nenin 20 pika ‘g’ është specifikuar detyra që ka organi më i lartë vendimmarrës i OJF-ve për të mbikëqyrur veprimtarinë e organizatës me qëllim parandalimin e përdorimit të burimeve të organizatës për qëllime terroriste, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në këtë ligj, përfshihet edhe rregullimi që ka bërë neni 22 në pikën ‘c’. Organi ekzekutiv bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për të siguruar që organizatat partnere dhe ato që sigurojnë financim, shërbime dhe mbështetje materiale, nuk përdoren apo manipulohen për qëllime terroriste.

[13] Neni 37 i ligjit nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, FZ 121, datë publikimi 02.08.2021.

[14] Neni 39 i ligjit nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, FZ 121, datë publikimi 02.08.2021.

[15] Neni 20/2 i ligjit nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, FZ 121, datë publikimi 02.08.2021.

[16] Neni 24 i ligjit nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, FZ 121, datë publikimi 02.08.2021.

[17] Neni 39/1 i ligjit nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, FZ 121, datë publikimi 02.08.2021.

[18] Ndryshuar me Ligjin nr.9814, datë 4.10.2007 dhe Ligjin nr.92/2013, datë 28.02.2013.

Pronari përfitues i OJF-ve regjistrohet në Regjistrin Elektronik të Pronarëve Përfitues.

Do të përfshihet në termin Pronar Përfitues[19] individi i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit subjektin dhe/ose individi në emër të të cilit po kryhet një transaksion ose veprimtari. Në rastin e OJF-ve përfshihet:

- Themeluesi ose përfaqësuesi ligjor ose individi që ushtron kontrollin e fundit efektiv në administrimin dhe kontrollin e organizatave jofitimprurëse, ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse. Kontrolli i fundit efektiv është marrëdhënia në të cilën një person: a) përcakton vendimet e marra nga organizata jofitimprurëse; b) kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së organeve vendimmarrëse dhe/ose organeve ekzekutive të organizatës jofitimprurëse.

OJF-të mund të bëjnë në të njëjtën kohë aplikimin për regjistrimin e personit juridik dhe regjistrimin e pronarit përfitues. Kur kemi refuzim të aplikimit të regjistrimit fillestar, regjistrimi duhet të kryhet brenda 40 (dyzet) ditëve nga data e refuzimit të aplikimit. Regjistrimi i pronarëve përfitues duhet të kryhet brenda 40 (dyzet) ditëve nga data e regjistrimit të OJF si person juridik. Kur ka ndryshim të pronarëve përfitues, regjistrimi duhet të kryhet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e ndryshimit[20].

OJF-të dhe personat e autorizuar për të bërë regjistrimin janë përgjegjës sipas ligjeve në fuqi për vërtetësinë e fakteve, të të dhënave të njoftuara dhe të dokumenteve shoqëruese, të depozituara në Regjistrin Elektronik të Pronarëve Përfitues.

OJF-të duhet të dinë që janë një nga subjektet raportuese të parashikuara shprehimisht nga Ligji për Pronarët Përfitues[21] dhe, për këtë arsye, kanë detyrimet përkatëse të parashikuara në këtë ligj.

[19] Neni 3 i Ligjit Nr. 112/2020 "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues", ndryshuar me aktin normativ nr. 12, datë 25.3.2021 dhe ligjin nr. 6/2022, datë 27.1.2022) (i përditësuar) Fletore Zyrtare 149, datë publikimi 13.08.2020.

[20] Neni 5 i Ligjit nr. 112/2020 "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues", ndryshuar me aktin normativ nr. 12, datë 25.3.2021 dhe ligjin nr. 6/2022, datë 27.1.2022) (i përditësuar) FZ 149, datë publikimi 13.08.2020.

[21] Neni 2 "Fusha e zbatimit"

Krahas detyrimeve të parashikuara në seksione të mëparshme të kësaj broshure, OJF-të duhet të mbajnë parasysh për zbatim edhe detyrimet e mëposhtme:

Të paktën një llogari bankare

OJF-të janë të detyruara që, brenda 20 (njëzet) ditëve nga regjistrimi për qëllime tatimore[22] (kur të jetë operativ Regjistri Elektronik i OJF, regjistrimi edhe për qëllime tatimore do të bëhet në këtë regjistër), të hapin llogari bankare dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore[23].

Kufijtë e veprimeve me para në dorë

Pagesat me para në dorë[24]: OJF-të duhet të dinë se, mund të kryejnë transaksione me para në dorë me vlerë deri në 150,000 lekë. Nuk do të konsiderohen si pagesa të kryera me para në dorë veprimet juridike të kryera nëpërmjet institucioneve financiare të parasë elektronike të licensuara nga Banka e Shqipërisë.

Kufijtë e kalimit të cash në kufijtë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë[25]

Po kështu, OJF-të duhet të dinë se çdo person, shqiptar ose i huaj, i cili hyn/largohet në/nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë është i detyruar të deklarojë shumat në të holla, çdo lloj letre me vlerë[26], metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shuma 10 000 euro ose kundërvlera e saj në monedha të tjera të huaja, si dhe qëllimin e mbartjes së tyre, për të cilat duhet të paraqesë dokumente justifikuese. Autoritetet doganore duhet të dërgojnë tek autoriteti përgjegjës kopje të formularëve të deklarimeve të mësipërme dhe të dokumenteve justifikuese të paraqitura. Autoritetet doganore duhet t'i raportojnë menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë autoritetit përgjegjës çdo dyshim, informacion ose të dhënë, që kanë lidhje me pastrim parash ose financim terrorizmi, për veprimtaritë nën juridiksionin e tyre[27].

Veprimet me faturë tatimore

OJF-të, si tatimpagues, duhet të lëshojnë faturë, për çdo furnizim mallrash apo shërbimesh që është pjesë e veprimtarisë së tyre ekonomike, pavarësisht nga qarkullimi vjetor i realizuar në vitin paraardhës ose në atë aktual[28]. Gjithashtu, OJF-të detyrohen të lëshojnë faturë si pranues të mallrave apo shërbimeve të furnizuara kur: (i) blejnë mallra ose shërbime nga

[22] Neni 59/1/1.3 e Ligjit 9920 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, FZ 85, datë publikimi 10.06.2008.

[23] Neni 59/1/3 i Ligjit 9920 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, FZ 85, datë publikimi 10.06.2008.

[24] Neni 59 i Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, FZ 85, datë publikimi 10.06.2008.

[25] Neni 17/1 i Ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit", ndryshuar me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011, ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012, ligjin nr. 44/2017, datë 6.4.2017, ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019, ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021, FZ 83, datë publikimi 10.06.2008

[26] Letër me vlerë monetare e ndryshme nga paraja.

[27] Neni 17 i Ligjit Nr.9917, datë 19.5.2008 "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit", ndryshuar me ligjin nr. 10 391, datë 3.3.2011, ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012, ligjin nr. 44/2017, datë 6.4.2017, ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019, ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021, FZ 83, datë publikimi 10.06.2008.

[28] Neni 4/c i Ligjit nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar.

individë që nuk kanë cilësinë e tregtarit dhe nuk janë të regjistruar në administratën tatimore si tatimpagues që lëshojnë fatura; (ii) blejnë shërbime të furnizuara nga një person i tatueshëm, që nuk është i vendosur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, përveç nëse ky person i tatueshëm, shitësi nga jashtë, lëshon një faturë elektronike, në përputhje me specifikimet teknike të përfshira në Standardet Shqiptare (SSH); (iii) blejnë mallra nga prodhuesit bujqësorë, që janë subjekte të skemës së kompensimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar[29].

OJF-të, jo më vonë se 24 orë përpara lëshimit të faturë në çdo vend që ushtrojnë veprimtarinë e biznesit, detyrohen të paraqesin të dhënat për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit nëpërmjet platformës qendrore të faturave[30].

IV LIGJI PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Organ mbikëqyrës[31] i OJF-ve, në kuptim të ligjit që mbulon parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, konsiderohen organet tatimore.

Organet tatimore kanë për detyrë që të mbledhin informacione të mjaftueshme për OJF-të për të kuptuar plotësisht burimet e financimit, natyrën e veprimtarisë dhe mënyrën e administrimit dhe drejtimit të tyre, të përcaktojnë nëpërmjet informacionit publik ose me mjete të tjera reputacionin e tyre, të marrin miratimin nga shkallë më të larta të organeve të administrimit/drejtimit përpara vendosjes së një marrëdhënieje biznesi me ta dhe të ofrojnë monitorim të zgjeruar të marrëdhënies së biznesit.

Pasqyrat financiare të OJF-ve kontrollohen dhe analizohen nga punonjës të specializuar të Drejtorisë Rajonale Tatimore (DRT)[32]. Do të kontrollohen burimet e financimit të OJF-ve, veprimtaria ekonomike, mënyra se si përdoren fondet dhe kapitali i OJF-së.

Në rast konstatimi të rasteve të dyshimta, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, paraqitet një raport në njësinë qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), ku kjo e fundit ia përcjell rastin Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)[33].

[29] Neni 7/2 i Ligjit nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar me ligjin nr.108/2020, datë29.7.2020.

[30] Neni 13/3 i Ligjit nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar me ligjin nr.108/2020, datë29.7.2020.

[31] Neni 41 i Ligjit nr. 8788/2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar me ligjin nr.9814, datë 4.10.2007, ligjin nr. 92/2013, datë 28.02.2013, FZ 28, datë publikimi 07.06.2001.

[32] Neni 7 i Udhëzimit nr.19, datë 09.07.2019, FZ 102, datë publikimi 15.07.2019.

[33] Neni 4 i Udhëzimit nr.19, datë 09.07.2019, FZ 102, datë publikimi 15.07.2019.

Raportet e kontabilitetit, të hartuara nga OJF-të për përdorimin e fondeve të donatorëve, si dhe pasqyrat financiare janë objekt kontrolli nga organet tatimore, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave sa herë që është e nevojshme.

Rregullat e hollësishme të mbikëqyrjes së OJF-ve nga organet tatimore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Raportimi nga organet tatimore mbi subjektet bëhet në bazë të procedurave të parashikuara në nenin 4 të ligjit nr. 9917/2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, i ndryshuar, duke zbatuar gjithashtu kërkesat e nenit 11 të këtij ligji. Organet tatimore i raportojnë autoritetit përgjegjës DPPPP, menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë, që ka të bëjë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

OJF-të nuk janë subjekte raportuese në kuptim të Ligjit 9917. Megjithatë, nëse ato kryejnë disa veprimtari të caktuara bëhen subjekte raportuese (Neni 3/k i Ligjit 9917 - Çdo person fizik apo juridik, përveç atyre të specifikuar në pikat a-j të nenit 3, të cilët merren me: ...

ii) ndërtimet; ...vi) sigurimin dhe administrimin e parasë fizike ose të titujve lehtësisht të konvertueshëm në emër të personave të tretë; vii) veprimtaritë e speditonit dhe transportit; ...ix) agjensitë e udhëtimit) dhe kanë si detyrim të deklarohen si subjekte raportuese për të bërë regjistrimet përkatëse pranë DPPPP dhe për të vepruar si subjekt raportues sa herë që për shkak të veprimtarisë së tyre vihen në dijeni të informacioneve të dyshimta të cilat duhen raportuar pranë DPPPP. Si shembull të OJF-ve të përfshira ose që mund të përfshihen në veprimtaritë e mësipërme janë ato OJF që krahas veprimtarisë jofitimprurëse joekonomike kryejnë edhe veprimtari jofitimprurëse ekonomike në një nga sektorët e sipërpërmendur. Në këto raste, këto OJF kualifikohen si subjekte raportuese të Ligjit 9917.

Detyrime të subjekteve raportuese: Raportimi te organet përgjegjëse bëhet brenda 72 orëve kur dyshohet se po kryhet aktiviteti kriminal. Kur subjekti ka dyshime se transaksionet që do kryhen në llogari të klientit do ndihmojnë në financimin e veprave penale, atëherë ai ka të drejtë të mos e kryejë këtë veprim. Brenda 48 orëve që nga marrja dijeni autoritetet përkatëse kthejnë përgjigje nëse klientit duhet t'i bllokohen fondet ose jo. Kur autoriteti përgjegjës nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, subjekti mund të vazhdojë me kryerjen e veprimit juridik.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) si autoriteti kryesor përgjegjës ku duhet të raportohet nga subjektet raportuese^[34] ka faqen e saj të internetit me një strukturë ku përmbahen ligje, urdhëra, udhëzime dhe vendime të ndryshme të cilat lidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. OJF-të janë të këshilluara ta konsultojnë faqen e internetit të DPPPP^[35].

[34] Neni 12 i Ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, ndryshuar me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011, ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012, ligjin nr. 44/2017, datë 6.4.2017, ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019, ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021, FZ 83, datë publikimi 10.06.2008.

[35] <https://fiu.gov.al/sq/>

Faqja e internetit të DPPPP përmban edhe listën e zezë të personave me të cilët nuk duhet të kryhen veprime juridike për shkak se këta persona janë deklaruar të padëshiruar nga organizma ndërkombëtare të specializuar ose nga autoritetet shqiptare.

V RREGULLORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË LIDHUR ME OJF

OJF-të janë objekt vlerësimi nga bankat e nivelit të dytë, pasi këto të fundit i klasifikojnë klientët e tyre në bazë të aktivitetit dhe burimeve të tyre të financimit.

Sipas Rregullores së Bankës së Shqipërisë miratuar me Vendimin Nr. 44, datë 10.06.2009 “Për Miratimin e Rregullores “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, OJF-të konsiderohen si kategori klientësh me risk të lartë[36].

Klasifikimi i klientëve sipas rrezikut bëhet, duke u bazuar mbi mundësinë që subjekti[37] të përdoret nga klienti me qëllimin e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit, ose që klienti të përdorë biznesin e tij me qëllim që të përziejë paratë e paligjshme me të ardhurat e ligjshme. Subjektet ndërmarrin masa shtesë për ata klientë të klasifikuar me rrezik të lartë. Rrethanat konkrete (për shembull, nëse një klient është vlerësuar me rrezik të lartë për shkak të strukturës së pronësisë së tij, subjektet duhet të përfshijnë një dispozitë në procedurat e tyre, që të përcaktojë nevojën e marrjes së të dhënave shtesë dhe verifikimin e mëtejshëm të dokumenteve të paraqitura) përcaktojnë edhe natyrën e masave që merren.

Subjektet, pasi kanë kryer identifikimin dhe verifikimin e klientit/pronarit përfitues (vendosjes së marrëdhënies së biznesit), strukturat përgjegjëse, klasifikojnë klientin në kategorinë e duhur në bazë të profilit të tij, si dhe përcaktojnë nivelin e rrezikut. Subjekti është i detyruar të kryejë këtë proces edhe për klientët ekzistues.

Nëse gjykohet e arsyeshme, strukturat përgjegjëse marrin vendim për të riklasifikuar kategorinë e klientit në një nivel më të lartë rreziku bazuar në procedura të brendshme lidhur me përditësimin e profilit të rrezikut të klientëve edhe nëse klientët nuk shfaqin një profil aktiviteti ndryshe nga ai fillestar. Klienti që nuk është i klasifikuar në nivelin me rrezik të lartë, si dhe ai që kategorizohet si klient me rrezik të lartë, rasti përsëri kanalizohet në një proces më të thellë monitorimi dhe analizimi-vigjilencë të zgjeruar.

[36] Tabela 1, Aneks 3, e Rregullores së BSH nr.44 date 10.06.2009.

[37] Neni 2 pika 14 i Ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, ndryshuar me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011, ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012, ligjin nr. 44/2017, datë 6.4.2017, ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019, ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021, FZ 83, datë publikimi 10.06.2008 - “Subjekt” është personi fizik ose juridik që vendos marrëdhënie biznesi me klientë, gjatë veprimtarisë së tij normale apo si pjesë e veprimtarisë tregtare ose profesionale të tij.

Gjithashtu, subjekti duhet të ruajë të dhënat e klientit, të cilat i paraqiten autoriteteve kompetente që të fillojnë menjëherë të shqyrtojnë procedurat për raportim në autoritetin përgjegjës, nëse nga analiza e mirëfilltë rezulton një rrezik potencial[38].

Treguesit e dyshimtë[39]

Treguesit e dyshimtë kanë për qëllim të ndihmojnë subjektet për vlerësimin/matjen për shenja të mundshme të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit dhe të reduktojnë kufijtë e pasigurisë lidhur me vlerësimet subjektive apo sjelljet diskrete, si dhe të kontribuojnë në sigurimin e përmbushjes së saktë dhe homogjene të detyrimeve të raportimit të transaksioneve të dyshimta.

Përfshihen në nivelin e lartë të rrezikut dhe ndaj tyre duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar të parashikuara në ligj apo aktet nënligjore:

Transaksionet e organizatave jo-fitimprurëse ose bamirëse:

- a) burimet e fondeve nuk janë në përputhje me madhësinë e fondeve të mbledhura, për shembull shuma të mëdha mblidhen nga komunitete, anëtarët e të cilëve kanë standard të ulët jetese;
- b) një rritje e papritur në frekuencën dhe madhësinë e transaksioneve ose e kundërta, për shembull fondet qëndrojnë në llogarinë e organizatës për një kohë të gjatë;
- c) dhurimet burojnë ekskluzivisht nga jo-rezidentët e vendit ku organizata është regjistruar;
- d) transfertat e fondeve në vende të ndryshme, veçanërisht në vendet me rrezikshmëri të lartë, kur kjo nuk justifikohet nga qëllimi i organizatës ashtu siç është specifikuar në statutin e saj;
- e) organizatat pa staf, zyra, numra telefoni, etj.

[38] Vendimin Nr.44, datë 10.06.2009 "Për Miratimin e Rregullores "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit", Aneksi 1.

[39] Vendimin Nr.44, datë 10.06.2009 "Për Miratimin e Rregullores "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit", Pika VI e Aneksit 1.

Njohja e indikatorëve të riskut orienton OJF-të që të përgatisin dhe të mbajnë në mënyrën e kërkuar nga ligji dokumentacionin financiar dhe operacional dhe të shmangin abuzimin dhe/apo përfshirjen në çështje të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Më poshtë përmendim indikatorët e riskut për financimin e terrorizmit që përdoren nga organet tatimore lidhur me sektorin e OJF-ve:

- Përdorimi i individëve që të kryejnë transferta monetare të OJF-ve në zona me aktivitet të njohur terrorist;
- Transaksionet e kryera në mënyrë të copëtuar në mënyrë që të shmangjet raportimi nga subjektet financiare;
- Raste kur kërkesat për transferimin e fondeve të OJF-ve shoqërohen me justifikime të paqarta;
- OJF-të sigurojnë financim nga organizata apo kompani fiktive;
- Përfaqësuesit e OJF-ve nuk bëjnë deklarin e vlerave monetare, instrumenteve të negociueshme apo gurëve/metaleve të çmuara në pikat e kalimit të kufirit;
- Llogaritë bankare të OJF-ve përdoren nga subjekte ndaj të cilëve zbatohen sanksione;
- Fondet e OJF-ve u transferohen subjekteve që besohet të jenë të angazhuara në aktivitete terroriste;
- OJF-të marrin fonde nga subjekte që besohet se mbështesin aktivitete terroriste;
- Fondet e OJF-ve bashkohen me fonde personale apo nga burime të biznesit;
- Fshehja e llogarive bankare që lidhen me programe apo aktivitete të caktuara;
- Fondet e OJF-ve u transferohen subjekteve që nuk janë të lidhur me programet ose aktivitetet e deklaruar;
- Objektet e OJF-ve frekuentohen nga individë që besohet të mbështesin aktivitete terroriste;
- OJF-të prokurojnë mallra me përdorim të dyfishtë;
- Burimet e një OJF-je sigurojnë ose transferojnë fonde nga / drejt një subjekti që njihet për angazhimin në aktivitete terroriste apo mbështetjen e tyre;
- OJF-të ndajnë pronën e tyre me një organizatë që besohet të mbështesë aktivitetin terrorist;
- OJF-të që nëpërmjet aktivitetit të tyre ofrojnë mbështetje për individë ose organizata, identiteti i të cilëve korrespondon me ato të subjekteve të listuara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara;
- Ekzistenca e informatave të besueshme që tregojnë se një OJF apo përfaqësues të saj janë të lidhura me palët e treta që mbështesin ose janë të angazhuar në veprimtari terroriste;
- Subjektet që veprojnë në zonat me aktivitete të njohura terroriste, depozitojnë fonde në llogaritë bankare të një OJF-je, drejtuesve ose punonjësve të saj;

[40] Shtojca 1 e Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.19 datë 09.07.2019 "Për Mbikëqyrjen e Organizatave Jofitimprurëse në funksion të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit", FZ 102, datë publikimi 15.07.2019.

- OJF-të transferojnë burime ose kryejnë aktivitete në një zonë ku subjektet terroriste njihen të kenë një prani të konsiderueshme;
- Të dhënat e OJF-ve mbahen në një zonë me prani të njohur të organizatave terroriste;
- Përfaqësuesit e OJF-ve, udhëtojnë shpesh në zona ku subjektet terroriste kanë një prani të konsiderueshme;
- OJF-të kanë aktivitete, programe apo partnerë të paraportuar;
- OJF-të përdorin një rrjet të pazakontë financiar për realizimin e operacioneve të tyre;
- OJF-të shmangin kërkesat e raportimit të detyrueshëm;
- Shpjegimet për programet dhe aktivitetet e OJF-ve tek organet mbikëqyrëse ose rregullatore, janë të paqarta;
- Palët e treta përdoren për të hapur llogari bankare të OJF-ve ose për të kryer transaksione në emër të tyre;
- Shpenzimet e OJF-ve nuk janë në përputhje me programet dhe aktivitetet e saj;
- OJF-ja nuk është në gjendje të ofrojë të dhëna për të ardhurat dhe përdorimin e burimeve të saj;
- Të dhëna publike për angazhimin e OJF-ve në aktivitete që lidhen me terrorizmin;
- OJF-të bashkohen me një organizatë tjetër që besohet të mbështesë aktivitete terroriste;
- Asistenca humanitare e OJF-ve synon të mbështesë individët e lidhur direkt me subjektet terroriste;
- Drejtuesit e një OJF janë ose kanë qenë drejtues apo punonjës të organizatave të tjera që besohet se mbështesin aktivitetin terrorist;
- OJF-të vuajnë nga një konflikt i brendshëm, ku një fraksion është i njohur të jetë dashamirës ose të përkrahë në mënyrë aktive subjekte terroriste;
- OJF-ja ka mospërputhje në raportimin e saj të pasqyrave financiare dhe raporteve të tjera të detyrueshme;
- OJF-të kanë ndryshime të shpeshta në strukturën drejtuese / vendimmarrëse;
- OJF-të ose përfaqësuesit e tyre përdorin dokumente të falsifikuara;
- OJF-të mbështesin terrorizmin ose subjektet terroriste nëpërmjet publikimeve ose predikimeve të përfaqësuesve të tyre;
- Drejtuesit ose punonjësit e një OJF-je, angazhohen në aktivitete që mbështesin rekrutimin e personave për zonat ndërkombëtare të konflikteve.

VII

MODELE TË DYSHIMTA TË PËRDORURA SI STANDARDE NDËRKOMBËTARE / KOMBËTARE ORIENTUESE PËR ZBULIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE TË FINANCIIMIT TË TERRORIZMIT[41]

Njohja e modeleve të mëposhtme të dyshimta orienton OJF-të që të përgatisin dhe të mbajnë në mënyrën e kërkuar nga ligji dokumentacionin finaciar dhe operacional dhe të shmangin abuzimin dhe/apo përfshirjen në çështje të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Më poshtë përmendim modele te dyshimta që përdoren nga organet tatimore për të identifikuar dyshime lidhur me abuzimin apo përfshirjen e subjekteve tatimpaguese, përfshirë OJF-të, në financimin e terrorizmit dhe pastrimin e parave:

- Taksapaguesi drejton një organizatë bamirësie, humanitare, edukative, etj., që duket e dyshimtë. Kontrolli bëhet në përputhje dhe me vigjilencën e zgjeruar ndaj këtyre subjekteve, siç përcaktohet nga legjislacioni për bankat dhe institucionet financiare jo banka.
- Taksapaguesi drejton biznesin (p.sh. zyrë shkëmbimi valutor) pa pasur një numër identifikimi të taksapaguesit (NIPT).
- Taksapaguesi heziton ose kundërshton që të japë informacion, lidhur me aktivitetin e biznesit ose jep dokumente të pazakonshme, ose të dyshimta për të identifikuar biznesin.
- Qëllimi i transaksionit / veprimit juridik / kontratave të taksapaguesit është i pakuptimtë në pikëpamje të biznesit ose nuk përputhet me biznesin / strategjinë e deklaruar të tij.
- Pasuria neto e taksapaguesit nuk përputhet me fondet.
- Informacioni i dhënë nga taksapaguesi lidhur me burimin e fondeve është i rremë, çorientues ose krejtësisht i gabuar.
- Kur i kërkohet, taksapaguesi refuzon të identifikojë ose nuk arrin të tregojë burimet e ligjshme të fondeve dhe pasurive të tjera.
- Taksapaguesi (ose personi i njohur publikisht si bashkëpunëtor) ka një histori të diskutueshme ose ka qenë objekt i medias për vepra të mundshme penale, civile apo rregullatore.
- Përdorimi i "personave juridikë" të shumtë, me qëllimin e vetëm marrjen dhe dorëzimin e fondeve.
- Zhvillimi i aktivitetit pa ndonjë qëllim të qartë biznesi në vende. shtete ose territore të identifikuar nga autoriteti përgjegjës si vende / shtete jo bashkëpunuese.
- Taksapaguesi është nga ose ka filiale (degë) në një vend ose territor të identifikuar si jo bashkëpunues nga FATF.

[41] Shtojca I e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.16/2009 "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit në Sistemin e Tatim-Taksave", FZ 14, datë publikimi 20.02.2009.

- Taksapaguesi shfaqet si agjent i një personi të padeklaruar dhe refuzon ose shmanget pa pasur arsye të ligjshme biznesi që të japë informacion lidhur me personin ose njësinë që përfaqëson.
- Taksapaguesi ka vështirësi për të përshkruar natyrën e biznesit ose i mungojnë njohuritë e përgjithshme të industrisë përkatëse.
- Taksapaguesi hap dhe mban disa regjistra kontabiliteti.
- Taksapaguesi paraqet fatura të rreme në Drejtorinë e Tatim - Taksave.
- Taksapaguesi, përmes personave të emëruar, përdor transaksione / veprime juridike / kontrata / marrëveshje fasade fiktive (transaksione të cilat nuk kanë përmbajtje ekonomike).
- Taksapaguesi kryen transaksione të shpeshta në cash, pavarësisht nga penalitetet.
- Llogaria e taksapaguesit tregon transaksione të shumta në valutë ose instrumente monetare, të cilat kur mblidhen arrijnë shuma të konsiderueshme.
- Blerja dhe shitja e letrave me vlerë pa qëllim dallueshëm, në rrethana që duken të pazakonshme dhe të palidhura me diversifikimin e investimit ose të rrezikut.
- Transaksionet që nuk i përmbahen praktikës normale në treg (p.sh. madhësisë së tregut, shpeshësisë, çmimeve, mbylljes së parakohshme të prodhimeve me humbje), veçanërisht, kur përfshihen para në dorë ose çeqe të rimbursueshme për palë të treta.
- Pagesa hyrëse të bëra nga çeqe të palëve të treta ose të nënshkruara nga disa palë.
- Taksapaguesi i përfshirë në transaksione që nuk kanë kuptim biznesi ose strategji të dukshme investimi, ose janë në mospërputhje me strategjinë e deklaruar të biznesit të taksapaguesit.
- Aktivitetet ose veprimet juridike (kontrata, marrëveshjet, etj.) të taksapaguesit janë tepër komplekse.
- Taksapaguesi përziën "pasuritë e biznesit" me ato personale.
- Llogaria e taksapaguesit ka transferta telegrafike që nuk kanë qëllim të dukshëm biznesi prej ose për të një vend i identifikuar si rrezik për pastrim parash, para të sekretit bankar, vende dhe banka offshore apo vend i lidhur me aktivitet terrorist (d.m.th. vende / shtete nën sanksione, vende jobashkëpunuese, kombe simpatizante).
- Taksapaguesi bën një depozitim fondesh me qëllim blerjen e një investimi afatgjatë të ndjekur, menjëherë pas kësaj, nga kërkesa për likuidim të pozicionit dhe transferim të të ardhurave jashtë llogarisë.
- Taksapaguesi kërkon që transaksioni të përpunohet në mënyrë të tillë që t'i shmanget kërkesave normale për dokumentim nga ana e firmës.
- Taksapaguesi, pa arsye bindëse ose me shenja të pazakonshme, është përfshirë në transaksione që përfshijnë lloje të caktuara letrash me vlerë, si tituj ndaj mbartësit që, megjithëse janë të ligjshme, janë përdorur në skemat mashtruese dhe aktivitet pastrimi parash. (Transaksione të tilla mund të kërkojnë procedura verifikimi për të vërtetuar ligjshmërinë e aktivitetit të taksapaguesit).
- Llogaria e taksapaguesit tregon një nivel pashpjegueshmërisht të lartë të aktivitetit të llogarisë me nivele shume të transaksioneve të letrave me vlerë.
- Llogaria e taksapaguesit ka hyrje fondesh ose pasurish të tjera që i kalojnë kufijtë e njohur të të ardhurave ose burimeve të taksapaguesit.
- Transaksione të kryera në favor të palëve të panjohura.
- Transferta të qarkulluara përmes bankave të shumta vendase ose të huaja.
- Mbajtja dhe përdorimi i shumë llogarive bankare të panevojshme.
- Rivlerësimi i aseteve të shoqërisë në vlera jashtë atyre të tregut.
- Deklarimi i fitimeve tepër të larta, të cilat nuk janë të zakonshme për llojin dhe fushën në të cilën zhvillohet ky aktivitet tregtar.

VIII

SHKELJET DHE SANKSIONET ADMINISTRATIVE

OJF-të dhe personat në organet drejtuese të OJF-ve, por edhe individët që punojnë në OJF, duhet të jenë të ndërgjegjësuar për shkeljet administrative lidhur me detyrimet ligjore për regjistrimet bazuar në Ligjin për Regjistrin e OJF-ve dhe Ligjin për Regjistrin e Pronarëve Përfitues, shkelja e të cilave përbën potencial për dyshime për përfshirjen e OJF-ve në parandalim të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe mbi shkeljet administrative lidhur drejtpërdrejtë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe përgjegjësinë administrative të tyre.

Ligji Nr.9917/2008 "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit"[42]

Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e dispozitave të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe autoriteti përgjegjës vendos një ose disa masa administrative siç janë paralajmërim, urdhër që detyron subjektin të ndalë një sjellje të caktuar, praktikë pune apo biznesi, si dhe të mos e përsërisë në të ardhmen, urdhër për pezullim të përkohshëm apo zëvendësim të drejtuesve të strukturave përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, gjobë dhe shpallje publike të kundërvajtësit dhe natyrës së kundërvajtjes.

Për caktimin e llojit dhe masës së sanksioneve, përveç kriterëve të vendosura në Ligjin për Kundërvajtjet Administrative, merren parasysh edhe kriteret që kanë të bëjnë me fuqinë financiare të personit juridik përgjegjës për shkeljen, përfitimet që mund të ketë pasur subjekti që ka kryer shkeljen, humbjet që mund të jenë shkaktuar ndaj palëve të treta për shkak të kryerjes së shkeljes (nëse ka pasur të tilla), nivelin e bashkëpunimit të subjektit me autoritetet kompetente dhe shkallën e përgjegjësisë së subjektit që ka kryer shkeljen. Në rastet kur autoriteti përgjegjës vlerëson se për shkeljen e konstatuar duhet të vendoset gjobë, subjektet gjobiten si më poshtë:

a) për rastet kur nuk zbatohen detyrimet e parashikuara në ligj, si dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, për nenet 4 (Rastet kur kërkohet vigjilenca e duhur), 4/1 (Masat e vigjilencës së duhur), pikat 1 e 1/1, 4/2 (Vigjilenca e thjeshtuar), 5 (Dokumentacioni i kërkuar për identifikimin e klientit), 6 (Zhvillimet teknologjike) dhe 6/1 (Mbështetja në palë të treta), subjektet gjobiten nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë;

b) për rastet kur nuk zbatohen detyrimet e parashikuara në ligj, si dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, për nenet 7 (Vigjilenca e zgjeruar ndaj klientit), pikat 1 dhe 2, 8 (Kategoritë e klientëve dhe transaksioneve, ndaj të cilëve zbatohet vigjilenca e zgjeruar),

[42] Neni 27 - Kundërvajtjet administrative.

9 (Shërbimet bankare ose financiare korrespondente), 10 (Detyrime për shërbimin e transferimit të parave ose të vlerave), 11 (Masat parandaluese të ndërmarra nga subjektet), 12 (Raportimi tek autoriteti përgjegjës), pika 3, 16 (Detyrimet për ruajtjen e të dhënave) e 21/1 (Detyrimi i subjekteve të ligjit dhe organeve publike për përgjigje ndaj kërkesave për informacion të autoritetit përgjegjës), subjektet gjobiten nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 8 000 000 (tetë milionë) lekë;

c) për rastet kur nuk zbatohen detyrimet dhe afatet e parashikuara në ligj, si dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji, për raportim të aktivitetit të dyshimtë, të parashikuara në nenet 4/1, pika 2, 7, pika 3, dhe 12, pikat 1 dhe 2,[43] subjektet gjobiten nga 300 000 (treqind mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

ç) për rastet kur nuk zbatohen detyrimet e parashikuara në nenin 3/1[44], organizimet gjobiten nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

d) për rastet kur nuk zbatohen urdhrat, kërkesat dhe afatet e autoritetit përgjegjës, të nxjerra sipas dispozitave të këtij ligji, detyrimet e parashikuara në nenet 14 e 15[45], personat dhe/ose subjektet gjobiten nga 300 000 (treqind mijë) lekë deri në 20 000 000 (njëzet milionë) lekë;

dh) përveç sa parashikohet në pikat më sipër, kur subjekti është një person juridik dhe kundërvajtja administrative është kryer:

- i)** nga një punonjës jo në nivel të lartë dhe/ose administrimi, apo agjent, personi apo agjenti që ka kryer shkeljen gjobitet nga 20 000 (njëzet mijë) lekë deri në 300 000 (treqind mijë) lekë;
- ii)** nga një administrator ose drejtues i subjektit, personi që ka kryer shkeljen gjobitet nga 40 000 (dyzet mijë) lekë deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

[43] Neni 4/1 - Masat e vigjilencës së duhur: 2. Kur subjektet janë të paafta që të plotësojnë detyrimet për vigjilencën e duhur ndaj klientit, sipas këtij neni dhe neneve 4, 4/1 e 5 të këtij ligji, duhet: a) të mos hapin llogari, të mos kryejnë transaksione dhe të mos fillojnë marrëdhënie biznesi; b) nëse ka filluar marrëdhënia e biznesit, ta ndërpresin atë; c) t'i dërgojnë raport për aktivitet të dyshimtë "autoritetit përgjegjës"; ç) të mos hapin apo të mos mbajnë llogari anonime, me emra fiktivë ose të identifikuar vetëm nëpërmjet një numri apo kodi, përfshirë depozitat apo instrumentet e tjera të mbajtësit. Nëse ka llogari të tilla, klientët e tyre duhet të identifikohen dhe të verifikohen, sipas parashikimeve të këtij neni. Nëse kjo nuk arrihet, llogaria duhet të mbyllet dhe t'i dërgohet raport për aktivitet të dyshimtë "autoritetit përgjegjës".

Neni 7 - Vigjilenca e zgjeruar ndaj klientit: 3. Kur subjektet janë të paafta që të plotësojnë detyrimet për vigjilencën e zgjeruar ndaj klientit, ato duhet të zbatohen masat e parashikuara në pikën 2, të nenit 4/1, të këtij ligji.

Neni 12 - Raportimi tek autoriteti përgjegjës: 1. Subjektet i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, ku parashirojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale, financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë. 2. Kur subjekti, ka dyshime se transaksioni mund të përfshijë pastrim të produkteve të veprës penale, financim terrorizmi apo fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale, ai duhet të mos e kryejë transaksionin, t'ia raportojë menjëherë rastin autoritetit përgjegjës dhe të kërkojë udhëzime nëse duhet ta kryejë apo jo transaksionin. Brenda 48 orëve nga marrja e tij, autoriteti përgjegjës kthen përgjigje, duke parashtruar qëndrimin për lejimin e transaksionit ose nxjerrjen e urdhrat të bllokimit. Kur autoriteti përgjegjës nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, subjekti mund të vazhdojë me kryerjen e transaksionit.

[44] Neni 3/1 - Detyrimet e organizimeve ligjore.

[45] Neni 15 – Kërkesat për mosdeklarim.

e) për rastet kur shkeljet e detyrimeve të parashikuara në ligj, si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij janë të rënda, të përsëritura, sistematike apo një kombinim i tyre, gjoha maksimale që mund të vendoset ndaj subjekteve është deri sa dyfishi i shumës së përfitimit të nxjerrë nga shkelja kur ai përfitim mund të përcaktohet ose deri në 125 000 000 (njëqind e njëzet e pesë milionë) lekë në rastet kur nuk mund të përcaktohet apo është më i vogël.

ë) përveçse sa parashikohet në pikat më sipër, për rastet kur shkeljet e detyrimeve të parashikuara në ligj, si dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij kryhen nga subjektet e përcaktuara në nenin 3, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, kur:

- i. subjekti është person juridik, vendoset gjobë deri në 10 (dhjetë) përqindëshin e qarkullimit total vjetor sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit të fundit, të miratuara, ku përfshihen edhe pasqyrat financiare të bijave në rastet kur subjekti është një shoqëri mëmë. Në rast se 10 (dhjetë) përqindëshi i qarkullimit total vjetor është më pak se 625 000 000 (gjashtëqind e njëzet e pesë milion lekë, nga autoriteti përgjegjës vendoset gjoha deri në 625 000 000 (gjashtëqind e njëzet e pesë milionë) lekë;
- ii. subjekti është person fizik, vendoset gjoha deri në 625 000 000 (gjashtëqind e njëzet e pesë milionë) lekë.

Gjobat përcaktohen dhe vendosen nga autoriteti përgjegjës.

Autoriteti përgjegjës informon autoritetet licencuese dhe/ose mbikëqyrëse për sanksionet e vendosura. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim procedurat e konstatimit, të shqyrtimit, të propozimit dhe të vendosjes së masave administrative nga autoriteti përgjegjës. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të gjobave, të vendosura me vendim të autoritetit përgjegjës, bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

E drejta për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, të parashikuara në këtë nen, nuk mund të ushtrohet kur kanë kaluar 5 vjet nga çasti i kryerjes së kundërvajtjes administrative.

Ligji Nr. 157/2013 “Për Masat Kundër Financimit të Terrorizmit”

Autoritet përgjegjës për kontrollin dhe mbikëqyrjen e përputhshmërisë së veprimtarisë së subjekteve të ligjit me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore për masat kundër financimit të terrorizmit është Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Nëse nuk përbën vepër penale, mospërmbushja nga organet përgjegjëse dhe subjektet e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Këto dënime administrative vendosen nga Ministri i Financave, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Procedurat e shqyrtimit, ankimit dhe të ekzekutimit të vendimeve për kundërvajtjet administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”[46].

Ligji Nr. 80/2021 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”[47]

Sipas këtij ligji, organizata jofitimprurëse, si dhe personat e autorizuar për të bërë regjistrimin janë përgjegjëse sipas ligjeve në fuqi për vërtetësinë e fakteve, të të dhënave të njoftuara dhe të dokumenteve shoqëruese të depozituara në regjistrin elektronik. Deklarimi në regjistrin elektronik i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 0.1% deri në 1% të të ardhurave vjetore të deklaruara nga organizata jofitimprurëse.

Moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 0.1% deri në 1% të të ardhurave vjetore të deklaruara nga organizata jofitimprurëse.

Në çdo rast, masa e gjobës, sipas paragrafeve më sipër, nuk mund të jetë më e vogël se 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.

Në rast se kancelari, kryesisht, konstaton që organizata jofitimprurëse ka deklaruar të dhëna të pavërteta ose nuk ka përmbushur detyrimet për regjistrim fillestar, apo regjistrime të tjera të detyrueshme, sipas paragrafeve më sipër, përpara marrjes së vendimit, njofton palët për paraqitjen e kërkesës për regjistrim ose korrigjimin e të dhënave. Në rast se brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, organizata jofitimprurëse, si dhe personat e autorizuar nuk paraqesin kërkesën, kancelari vendos gjobën përkatëse e parashikuar në ligj.

Gjoha vendoset nga kancelari sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative. Vendimi i kancelarit për dënimin me gjobë ankimohet drejtpërdrejt në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Mospërmbushja e detyrimit për regjistrimin ose çregjistrimin e organizatës jofitimprurëse dhe depozitimim e akteve të tjera në regjistër brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, dënohet nga gjykata me gjobë nga 0.1% deri në 1% të të ardhurave vjetore të deklaruara

[46] Neni 27 - Kundërvajtjet administrative.

[47] Neni 49 - Kundërvajtjet administrative.

nga organizata jofitimprurëse. Në çdo rast, masa e gjobës nuk mund të jetë më e vogël se 30.000 (tridhjetë mijë) lekë. Kundër vendimit për dënimin me gjobë mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit[48].

Ligji Nr. 112/2020 “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”[49]

OJF-të dhe personat e autorizuar për të bërë regjistrimin janë përgjegjës sipas ligjeve në fuqi për vërtetësinë e fakteve, të të dhënave të njoftuara dhe të dokumenteve shoqëruese, të depozituara në regjistrin elektronik.

Shkeljet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

- a) mosregjistrimi fillestar i të dhënave për pronarin përfitues të tij brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 5 [50] të ligjit dënohet me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
- b) mosregjistrimi fillestar i të dhënave për pronarin përfitues të tij brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 3 të nenit 5[51] të ligjit dënohet me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
- c) mosregjistrimi fillestar i të dhënave për pronarin përfitues të tij brenda 40 (dyzet) ditësh pas përfundimit të afatit të përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 5 të ligjit dënohet me gjobë në vlerën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë;
- ç) mosregjistrimi fillestar i të dhënave për pronarin përfitues të tij brenda 40 (dyzet) ditësh pas përfundimit të afatit të përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 3 të nenit 5 të ligjit dënohet me gjobë në vlerën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë;
- d) mosregjistrimi i çdo ndryshimi në të dhënat e regjistruara, që depozitohen në regjistër, brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “ç” të pikës 3 të nenit 5[52] të ligjit dënohet me gjobë në vlerën 400 000 (katërqind mijë) lekë.

Gjoha vendoset nga titullari i QKB-së, vendimi i të cilit ankimohet drejtpërdrejt në gjykatën administrative kompetente në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

QKB-ja dhe autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse për subjektet raportuese, të cilat kryejnë shkeljet e parashikuara në paragrafin 2 më sipër, nuk do të ofrojnë shërbimet ndaj tyre, përveç regjistrimit të ndryshimeve të të dhënave të përfaqësuesit ligjor, si dhe do të ndryshojnë statusin për subjektet raportuese nga statusi “aktiv” në statusin “të pezulluar” në regjistrin tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave

[48] Kreu VII/1, Neni 39/1 - Kundërvajtjet administrative.

[49] Neni 13 - Kundërvajtjet administrative.

[50]3.Regjistrimi nga subjektet raportuese i të dhënave të pronarëve përfitues në Regjistrin ePronarëve Përfitues bëhet në afatet e mëposhtme: ... b) në rastet e refuzimit të aplikimit për regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues ngasubjektet raportuese, që regjistrohen në regjistrin tregtar me pronësi indirekte, regjistrimi bëhet brenda 40 (dyzet) ditëve kalendarike nga data e refuzimit të aplikimit;

[51]...c) në rastet e regjistrimit fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese, që regjistrohen në regjistrin e organizatave jofitimprurëse, regjistrimi bëhet brenda 40 (dyzet) ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese si person juridik;

[52] ç) në rastin e regjistrimit të ndryshimeve të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese, regjistrimi bëhet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e ndodhjes së ndryshimit faktik.

Jofitimprurëse deri në pagimin e gjobës dhe regjistrimin e të dhënave përkatëse për pronarët përfitues.

Mospërmbushja e detyrimeve ligjore të përcaktuara në pikën 1 të nenit 5[53] të ligjit përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Kjo gjobë, sipas paragrafit pararendës vendoset nga autoritetet shtetërore inspektuese / verifikuese në fushën tatimore, të përcaktuara në pikën 4 të nenit 9[54] të ligjit, vendimi i të cilave ankimohet drejtpërdrejt në gjykatën administrative kompetente në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

IX

VEPRAT PENALE

të posaçme lidhur me Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizimit

OJF-të dhe personat në organet drejtuese të OJF-ve, por edhe individët që punojnë në OJF, duhet të jenë të ndërgjegjësuar për veprat penale lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe përgjegjësinë penale të tyre. Gjejmë me vend të kujtojmë që legjislacioni ynë edhe përgjegjësinë penale të personave juridikë. Kodi ynë penal parashikon edhe për vepra penale të kryera nga shtetas të huaj.

Skemat mashtruese dhe piramidale[55]

Organizimi dhe vënia në funksionim e skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes, me qëllim fitimi material, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet. Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Vepra me qëllime terroriste[56]

Kryerja e veprave, me qëllim përhapjen e panikut në popullatë ose për të detyruar organe shtetërore, shqiptare ose të huaja, të kryejnë ose të mos kryejnë një akt të caktuar, ose për të shkatërruar apo destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me

[53]1. Subjektet raportuese kanë detyrimin të ruajnë dhe të mbajnë të dhëna dhe dokumenteshoqëruese të duhura, të sakta e të përditësuara, në bazë të të cilave përcaktohen pronarët përfitues të subjektit dhe lloji i kontrollit të pronarëve të tyre përfitues.

[54]4. Autoritetet shtetërore inspektuese/verifikuese në fushën tatimore, në kuadër të kontrollit sipas legjislacionit në fuqi të fushës përkatëse, kryejnë verifikimin për saktësinë dhe përputhshmërinë e të dhënave të raportuara në regjistrë nga subjektet raportuese me të dhënat e mbajtura nga subjekti sipas pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji.

[55] Neni 143/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

[56] Neni 230 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

burgim të përjetshëm. Veprat me qëllime terroriste përfshijnë: ... h) vjedhjen, përvetësimin ose përfitimin nëpërmjet mashtrimit të materialeve bërthamore.

Financimi i terrorizmit[57]

Dhënia ose grumbullimi i fondeve, me çdo mjet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me qëllimin që ato të përdoren ose duke ditur se ato do të përdoren, plotësisht ose pjesërisht:

- a) për të kryer vepra me qëllime terroriste;
- b) nga një organizatë terroriste;
- c) nga një terrorist i vetëm;

dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

Këto dispozita[58] zbatohen:

- a) për të gjitha fondet, ku përfshihen pasuri të çdo lloji, të trupëzuara ose të patrupëzuara, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e fitimit të tyre, dhe dokumente ligjore ose instrumente të çdo lloji, edhe në formë elektronike ose digjitale, që tregojnë të drejta ose interesa mbi pasuri të tilla, përfshirë kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, çeqet e garantuara bankare, letrat e kreditit, si dhe çdo instrument tjetër financiar, të ngjashëm me to;
- b) pavarësisht nëse personi që kryen një nga veprat e parashikuara më sipër, ndodhet në të njëjtin shtet a në një shtet të ndryshëm nga ai, në të cilin ndodhet organizata terroriste a terroristi i vetëm ose nga shteti në të cilin është kryer a do të kryhet vepra me qëllime terroriste;
- c) në rastin e parashikuar më sipër në këtë pikë, pavarësisht nëse fondet janë përdorur në fakt për të kryer veprën ose veprat, për të cilat ishin dhënë ose grumbulluar, apo nëse mund të vendoset një lidhje mes fondeve dhe një apo më shumë veprave konkrete me qëllime terroriste.

Dijenja dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.

Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin[59]

Transferimi, konvertimi, fshehja, lëvizja ose tjetërsimi i fondeve dhe i pasurive të tjera, ndaj të cilave zbatohen masat kundër financimit të terrorizmit, për të shmangur zbulimin dhe vendndodhjen e tyre, dënohen me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet.

[57] Neni 230/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

[58] Neni 230/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

[59] Neni 230/b i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet, ndërsa kur kryerja e kësaj vepre ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit[60]

Vënia në dijeni e personave të shpallur ose e personave të tjerë për të dhënat për verifikimin ose hetimin e fondeve dhe pasurive të tjera, ndaj të cilave zbatohen masa kundër financimit të terrorizmit, nga persona që ushtrojnë funksione publike ose që janë në ushtrim të detyrës a profesionit, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur[61]

Dhënia e fondeve dhe pasurive të tjera, kryerja e shërbimeve financiare, si dhe e transaksioneve të tjera me persona të shpallur, ndaj të cilëve zbatohen masa kundër financimit të terrorizmit, dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit[62]

Rekrutimi i një ose më shumë personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit, edhe kur këto vepra drejtohen kundër një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim jo më pak se dhjetë vjet.

Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste[63]

Përgatitja, stërvitja dhe dhënia në çdo formë e udhëzimeve edhe në mënyrë anonime ose në rrugë elektronike, për prodhimin ose përdorimin e lëndëve eksplozive, armëve të zjarrit dhe municioneve luftarake, të armëve të tjera dhe lëndëve kimike, bakteriologjike apo bërthamore ose të çdo natyre tjetër, të dëmshme dhe të rrezikshme për njerëzit dhe pasurinë, si dhe të teknikave e të metodave të tjera për kryerjen e veprave me qëllime terroriste dhe pjesëmarrja në veprimtari të tilla, edhe kur këto vepra drejtohen kundër një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohen me burgim jo më pak se shtatë vjet.

Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste[64]

Nxitja, thirrja publike, shpërndarja e shkrimeve ose propaganda në forma të tjera, që

[60] Neni 230/c i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

[61] Neni 230/ç i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

[62] Neni 231 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

[63] Neni 232 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

[64] Neni 232/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

synon mbështetjen ose kryerjen e një apo më shumë veprave për qëllime terroriste dhe për financimin e terrorizmit, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

Organizata terroriste[65]

Krijimi, organizimi, drejtimi dhe financimi i organizatës terroriste dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Pjesëmarrja në organizata terroriste dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale[66]

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet:

- a)këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;*
- b)fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;*
- c)fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;*
- d)kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;*
- e)investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;*
- f)këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.*

Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim.

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:

- a)vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;*
- b)ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar;*
- c)personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;*

[65] Neni 234/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

[66] Neni 287 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

d) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;
e) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë.

Dijenja dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.

Çelja e llogarive anonime[67]

Çelja e depozitave ose e llogarive bankare, anonime ose me emra fiktivë, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale[68]

Kushdo që blen, merr, fsheh apo, në një mënyrë tjetër, përvetëson për vete ose një palë të tretë, apo ndihmon në blerjen, marrjen, fshehjen ose përdorimin e parave apo mallrave të tjera, duke ditur se një person tjetër ka përfituar këto para apo mallra, si pasojë e kryerjes së një vepre penale ose veprimtarie kriminale, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.

Paragrafi i parë i këtij neni zbatohet pavarësisht ndalimit ligjor për të marrë në përgjegjësi penale personin që ka kryer veprën penale, nga e cila rrjedh përvetësimi i parave ose i mallrave të tjera.

Moskallëzimi i krimit[69]

Moskallëzimi në organet e ndjekjes penale, në gjykatë, në organet e rendit publik, të pushtetit ose të administratës, i një krimi që është duke u kryer apo që është kryer, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Përrjashtohen nga detyrimi për kallëzim të paralindurit dhe të paslindurit, vëllezërit dhe motrat, bashkëshorti, adoptuesi dhe të adoptuarit, si edhe personat që janë të detyruar të ruajnë një sekret të njohur për shkak të detyrës apo profesionit.

[67] Neni 287/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

[68] Neni 287/b i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

[69] Neni 300 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.



PJESA E DYTË

*Raste studimore mbi rrezikun e abuzimit
terrorist në sektorin e OJF-ve*

Rast Studimor

Në 2011, Policia e West Midlands, në bashkëpunim me Shërbimin Britanik të Sigurisë dhe Shërbimin Policor Metropolitan të Londrës, filloi një hetim ndaj disa individëve me bazë në Birmingham. Dy nga subjektet kryesore të hetimit Irfan Naseer dhe Irfan Khalid, kishin bërë udhëtime në Pakistan në vitin 2009 dhe 2010, ku kishin regjistruar video vetëvrasje dhe kishin ndjekur trajnime për përgatitjen e aktivitetit terrorist. Mbikëqyrja fizike dhe teknike e Naseerit, Khalid dhe bashkëpunëtori Ashik Ali zbuloi një komplot të rëndësishëm për të shpërthyer deri në tetë mjete shpërthyes në vende të mbushura me njerëz rreth Birminghamit.

Mbikëqyrja fizike zbuloi se Naseer, Khalid dhe Ali ishin angazhuar në mbledhjen e fondeve në rrugë për organizatën e madhe bamirëse Muslim Aid në Mbretërinë e Bashkuar. Hetuesit zbuluan se komplotistët kishin punuar vullnetarisht me Myslym Aid për mbledhje fondesh duke marrë kuti për dhurimet dhe jelekë me shikueshmëri të lartë me emrin e organizatës bamirëse në to. Tre burrat mblodhën dhurime gjatë një dite të vetme dhe i dorëzuan 2,500 USD donacione Muslim Aid.

Megjithatë, përpara se të kthenin kutitë dhe jelekët e dhurimit, dhe pa e ditur Muslim Aid, të tre burrat vazhduan të mblidhnin fonde edhe për disa ditë të tjera duke u paraqitur si vullnetarë të Muslim Aid. Dhurimet e mbledhura gjatë këtyre ditëve në vijim u depozituan në llogaritë bankare personale të komplotuesve. Në total, ata devijuan 23,000 USD dhurime për të financuar komplotin e bombave. Një skemë e ngjashme u përdor gjithashtu për të mashtruar një tjetër organizatë bamirëse, Medresah-e-Ashraful Uloom.

Në shtator 2011, policia ndaloi komplotin për bombë, duke arrestuar Naseer, Khalid, Ali dhe disa të dyshuar të tjerë. Të tre u dënuan me akuza për terrorizëm në shkurt 2013 dhe u dënuan me burgim nga 15 vjet deri në burgim të përjetshëm.

Pas arrestimeve të vitit 2011, policia njoftoi Muslim Aid se organizata ishte abuzuar nga komplotuesit e bombave. Muslim Aid paraqiti një raport për incidentin e rëndë në Komisionin e Bamirësisë së Anglisë dhe Uellsit, i cili është rregullatori kombëtar i bamirësisë në Mbretërinë e Bashkuar. Komisioni punoi me organizatat bamirëse të përfshira për të rishikuar dhe forcuar masat e tyre mbrojtëse për të zbutur rrezikun e abuzimeve në të ardhmen.

Rast Studimor 2

Një bombë e bërë vetë shpërtheu në një shtëpi në të cilën shfaqej një banderolë e një OJF-je që mbështeste jetimët. Një hetim zbuloi se OJF-ja e reklamuar nuk ekzistonte dhe se një grup terrorist po maskonte objektin e tij të prodhimit të bombave si një zyrë OJF-je.

Autoritetet ligjzbatuese kapën një sasi të madhe furnizimesh për prodhimin e bombave dhe armëve. Një anëtar i grupit terrorist u akuzua dhe u dënua për vepra të lidhura me terrorizmin.

Rast Studimor 3

Devijimi i fondeve nga aktorë të brendshëm të OJF-ve - Faza e transferimit

Një OJF lokale u krijua për të siguruar një vend kulti fetar për një komunitet të diasporës që kishte ardhur nga një zonë konflikti dhe për të mbledhur dhe shpërndarë fonde për qëllime humanitare.

Rregullatori kombëtar i OJF-ve filloi të dyshonte kur nga raportimi i detyrueshëm i OJF-së rezultoi se ajo kishte dërguar fonde për organizata që nuk ishin përfituese, të përcaktuar sipas ligjit. Këto fonde u dërguan në dukje si përgjigje ndaj një fatkeqësie natyrore që kishte prekur atdheun e komunitetit të diasporës. Megjithatë, një nga organizatat përfituese besohet të ishte dega lokale e një organizate ndërkombëtar që shërbente si front për një grup të huaj terrorist që vepronte në atdheun e komunitetit të diasporës.

Rregullatori auditoi OJF-në dhe zbuloi se kishte dërguar fonde pesë organizatave ose individëve që nuk ishin përfitues të përcaktuar me ligj. Kjo përfshinte 50,000 USD dërguar organizatës ndërkombëtare të frontit përmes degës së saj të brendshme dhe 80,000 USD të dërguara direkt në degën qendrore të organizatës që ndodhet në zonën e konfliktit.

Ndërkohë që auditimi ishte në vazhdim, rregullatori siguroi dy dëshmi nga publiku në lidhje me OJF-në. Të dy dëshmitë cituan shqetësime në lidhje me paqartësinë e organeve drejtuese të OJF-së dhe se vendimet për të dërguar fonde jashtë shtetit kishin anashkaluar procedurat normale të llogaridhënies të përcaktuara në dokumentet qeverisëse të OJF-së. Një nga dëshmitë tregonte se një ndryshim në demografinë e komunitetit të diasporës do të thonte se një fraksion i ri kishte fituar kontrollin e bordit të drejtorëve të OJF-së. Ky fraksion ishte më dashamirës ndaj kauzës së organizatës së huaj terroriste. Ndërkohë që këto çështje ishin vënë re tashmë përmes auditimit të rregullatorit, të dhënat mbështetën shqetësimet e rregullatorit në lidhje me menaxhimin e OJF-së.

Drejtuesit e OJF-së iu përgjigjën shqetësimeve të rregullatorit duke deklaruar se nevoja urgjente për t'iu përgjigjur një fatkeqësie natyrore e kishte shtyrë OJF-në të anashkalonte disa procedura të brendshme dhe të punonte me çdo organizatë që mund të vepronte në zonat e prekura. Duke marrë parasysh këtë, OJF-ja ruajti regjistrimin e saj, por u detyrua të paguante gjoba. OJF-ja gjithashtu hyri në një marrëveshje përputhshmërie me rregullatorin për të zbatuar standarde strikte të kujdesit të duhur dhe llogaridhënies.

Rast Studimor 4

Devijimi i fondeve nga aktorë të jashtëm të OJF-së - Faza e transferimit

Në përgjigje të një fatkeqësie humanitare, një OJF e madhe ndërkombëtare ofroi ndihmë me anë të pagesave me para në dorë (cash) për përfituesit në zonat e kontrolluara nga një organizatë terroriste.

OJF-ja dorëzoi pagesat me para në dorë përmes një subjekti lokal të shërbimit të parasë (Money Service Business - MSB).

Nga një shqyrtim i programit të ndihmës humanitare i kryer nga një prej organizatave partnere të OJF-së në emër të saj, u ngritën shqetësime. Shqyrtimi zbuloi se, në raste të caktuara, MSB mbante një "taksë" e cila i kalonte një organizatë terroriste të listuar. Në raste të tjera, përfituesit e fondeve të bamirësisë taksoheshin nga vetë përfaqësuesit e organizatës terroriste pas marrjes së ndihmës financiare. Shqyrtimi zbuloi gjithashtu se ekzistonte një mirëkuptim dhe pranim i përgjithshëm se një pjesë e fondeve bamirëse do të devijoheshin për qëllime terroriste dhe se kjo ishte praktikë e zakonshme midis OJF-ve dhe organizatave që punojnë në zonë.

Pas një hetimi të përbashkët nga rregullatori kombëtar i OJF-ve, Njësia e Inteligjencës Financiare kombëtare dhe autoritetet ligjzbatuese, OJF-ja u informua për përgjegjësitë e saj në lidhje me raportimin e incidenteve të tilla dhe iu kërkua të ofronte trajnime për stafin e saj në mënyrë që të mbrohet më mirë kundër incidenteve të ngjashme në të ardhmen.

Rast Studimor 5

Devijimi i Fondeve

Një drejtues i një OJF-je lokale, me autoritet për të nënshkruar në emër dhe për llogari të OJF-së, u përpoq të bënte një depozitë të madhe parash cash në llogarinë e OJF-së. Individu tregoi se fondet do t'i transferoheshin një avokati për blerjen e një pasurie të paluajtshme. Ai ishte i paqartë lidhur me origjinën e fondeve, por bëri një referencë indirekte për dhurimin. Banka refuzoi të pranonte depozitën me arsyetimin se dega ku u tentua të depozitohesh shumta nuk e mbante llogarinë dhe depozitoi një Raport Transaksioni të Dyshimtë i cili njoftoi Njësinë e Inteligjencës Financiare kombëtare. Hetimi i Njësisë së Inteligjencës Financiare zbuloi se i njëjti individ kishte bërë një sërë depozitash të mëdha parash direkt në llogarinë e OJF-së. Hetimi zbuloi gjithashtu depozita të shumta cash në llogarinë personale të individit që korrespondonin me donacionet e OJF-së nga donatorë privatë. Individu kishte kryer disa transferta ndërkombëtare nga llogaria e tij personale te një individ i huaj me lidhje të njohura me një grup të huaj terrorist.

Hetimi i Njësisë së Inteligjencës Financiare përcaktoi se OJF-ja ishte përdorur për të mbledhur fonde që më pas u devijuan pjesërisht për të mbështetur aktivitetet terroriste jashtë shtetit. Dosja i kaloi organeve përkatëse ligjzbatuese dhe gjyqësore për hetime të mëtejshme.

Devijimi i Fondeve

Nje bankë paraqiti një Raport Transaksioni të Dyshimtë pas një transferimi të fondeve të bëra nga një OJF lokale te një OJF e huaj, e cila ishte e listuar si një subjekt terrorist për shkak të përpjekjeve të saj për mbledhjen e fondeve për një organizatë terroriste të listuar.

Nga një hetim i autoriteteve ligjzbatuese i kryer në bashkëpunim me disa agjensi qeveritare vendase, u arrit në përfundimin se OJF-ja lokale kishte transferuar 800 000 USD për OJF-në e huaj të listuar. Drejtuesit e OJF-së lokale pranuan se kanë ofruar fonde për ndihmë humanitare. Megjithatë, u arrit në përfundimin se drejtuesit nuk ishin në dijeni të statusit të OJF-së së huaj si një subjekt i listuar.

Autoritetet nuk kërkuar të ndjekin penalisht drejtuesit e OJF-së. Megjithatë, për të shmangur rrezikun e abuzimit në të ardhmen, drejtuesit e rritën kujdesin e tyre të duhur duke u njohur me listën e subjekteve të përcaktuara terroriste dhe duke kërkuar udhëzime nga autoritetet për transferimin e fondeve në juridiksione të caktuara.

Rast Studimor

Devijimi i Fondeve

Një OJF që kryen punë humanitare dhe kulturore në nivel lokal dhe ndërkombëtar aplikoi dhe u regjistrua nga rregullatori kombëtar i OJF-ve. Një nga aktivitetet kryesore të OJF-se ishte të drejtonte një shkollë fetare lokale. Rregullatori filloi të shqetësohej kur nga raportimi i detyrueshëm i OJF-së rezultoi se OJF-ja kishte transferuar fonde te organizata ndërkombëtare që nuk ishin përfitues të miratuar ligjshëm. OJF-ja u auditua nga rregullatori kombëtar dhe u përcaktua se kishte një sërë çështjesh të përputhshmërisë dhe rrezikut. Shqyrtimi i informacionit të programit të OJF-së zbuloi se ajo ishte pjesë e një rrjeti të OJF-ve lokale që kishin të njëjtët drejtues dhe bashkëpunonin në projekte. Disa nga organizatat lokale me të cilat OJF-ja bashkëpunonte, dihej se ishin të lidhura me subjekte të huaja terroriste. Një individ i punësuar si drejtues i shkollës fetare ishte i njohur nga rregullatori për përfshirje në aktivitete që mund të nxisin rekrutimin në aktivitete terroriste. Disa grupe të komunitetit regjistruan gjithashtu shqetësime për elementët e kurrikulës së shkollës, por një hetim i autoriteteve vendore ligjzbatuese përcaktoi se nuk kishte asnjë qëllim nga ana e OJF-së për t'u përfshirë në aktivitete që mbështesin rekrutimin.

Gjithashtu, u konstatua se OJF-ja nuk funksiononte si një subjekt i pavarur (siç e kërkonte ligji), por si degë e dy organizatave më të mëdha të huaja. Një sasi e konsiderueshme e fondeve të OJF-së transferoheshin te organizatat e huaja dhe rekordet financiare për përdorimin e fondeve mbaheshin nga organizatat e huaja dhe jo nga OJF-ja lokale.

Rregullatori kombëtar përcaktoi se mangësitë e pajtueshmërisë dhe të kujdesit të duhur, mungesa e kontrollit të operacioneve ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me organizata dhe individë të tjerë me interes e bënë OJF-në shumë të cënueshme ndaj shfrytëzimit. Rregullatori edukoi OJF-në lidhur me detyrimet e saj ligjore dhe të pajtueshmërisë, dhe hartoi një marrëveshje përputhshmërie me OJF-në për të forcuar llogaridhënien dhe monitorimin. Rasti është në vazhdim.



Devijimi i Fondeve

Një OJF lokale e regjistruar i dha një grupi të vullnetarëve të saj materiale për mbledhjen e fondeve, duke përfshirë kuti grumbullimi, simbole identiteti dhe letra kredenciale për të mbledhur fonde dhe mallra të tjera në mbështetje të individëve të prekur nga një krizë humanitare në emër të OJF-së. Përveç mbledhjes së fondeve, vullnetarët u ngarkuan me shpërndarjen e donacioneve për ata që kishin nevojë.

Drejtuesit e OJF-së ushtronin mbikqyrje minimale të aktivitetit të vullnetarëve të saj, duke përfshirë edhe shpërndarjen e donacioneve e dëshmuar nga mungesa e të dhënave. Drejtuesit nuk ishin në gjendje të tregonin se fondet dhe mallrat e mbledhura ishin shpërndarë për qëllimet e synuara dhe mbështeteshin vetëm në të dhënat e ofruara nga vullnetarët e saj. Një shqyrtim i rregullatorit kombëtar të OJF-ve zbuloi se një nga vullnetarët i mbajti materialet për mbledhjen e fondeve të OJF-së në kundërshtim me legjislacionin vendas, i cili përfshinte sanksione financiare, bazuar në lidhje të dyshuara me terrorizmin. Rregullatori i OJF-ve i paralajmëroi drejtuesit e OJF-së lidhur me këtë përcaktim dhe i këshilloi ata që të ndërmarrin veprime për të siguruar që çdo pronë që i përket OJF-së të rikuperohej dhe të parandalonin aktivitete të mëtejshme financiare në shkelje të sanksioneve të vendosura brenda vendit.

Mundësia që individi i caktuar të ketë përdorur materialet për mbledhjen e fondeve të OJF-së për të mbledhur dhe kërkuar donacione në mbështetje të terrorizmit nuk mund të përjashtohet.



Devijimi i Fondeve

Një OJF lokale, e krijuar për të mbështetur nevojat humanitare të jetimeve, u bë subjekt i një vizite inspektimi nga rregullatori kombëtar i OJF-ve.

Rregullatori kombëtar zbuloi shkelje të shumta ligjore që çuan në dyshimin për mbështetje të financimit të terrorizmit. OJF-ja filloi veprimtarinë përpara se të licencohej dhe nuk arriti të paraqiste pasqyrat financiare të kërkuara pranë autoriteteve kompetente. Ajo mblodhi fonde, dërgoi dhe përfitoi transferta fondesh pa miratimin e duhur. Përveç kësaj, OJF-ja nuk përdorte banka të miratuara nga rregullatori kombëtar dhe përdorte llogari bankare personale që u përkisnin drejtuesve dhe stafit kur kryente transaksione në lidhje me aktivitetet e OJF-së. Hetimi i rregullatorit zbuloi gjithashtu se OJF-ja kishte ndërmarrë projekte dhe aktivitete duke përfshirë aktivitete politike të cilat nuk ishin në përputhje me qëllimet e raportuara të saj. Kishte dhe partnerë të huaj të paraportuar.

Në dritën e këtyre gjetjeve, rregullatori kombëtar ngriu llogaritë bankare të OJF-së, mbylli përkohësisht veprimtarinë e saj dhe ndryshoi bordin e saj të drejtorëve.

Rast Studimor

Përfaqësimi i rremë dhe OJF-të e rreme - Faza e grumbullimit

Dy individë po mblidhnin fonde brenda vendit për një anëtar të familjes që po luftonte përkrah një organizate terroriste të listuar jashtë vendit. Individët, të cilët pretendonin se ishin përfaqësues të një OJF-je të njohur humanitare lokale, mblidhnin fondet publikisht në rrugë. Kjo përpjekje ishte në kundërshtim me legjislacionin vendas.

Individët në fjalë nuk kishin miratimin e OJF-së lokale për të kërkuar donacione në emër të saj dhe as nuk kishin dorëzuar fondet e mbledhura pranë OJF-së. Pasi u grumbullua një shumë e konsiderueshme parash, ato iu dërguan anëtarit të familjes jashtë vendit duke përdorur transferta bankare.

Si rezultat i një hetimi të përbashkët midis Njesisë së Inteligjencës Financiare, rregullatorit të OJF-ve dhe autoriteteve ligjzbatuese, të dy individët u arrestuan dhe u dënuan për mbledhje fondesh terroriste dhe u dënuan me burg.

Rast Studimi

Mbështetje për Rekrutim

Një OJF lokale rezultoi se kishte organizuar aktivitete dhe takime të ndjekura nga folës të njohur për promovimin e ekstremizmit të dhunshëm. Audiencat e aktiviteteve ishin me qindra dhe aktivitetet / takimet ishin objekt i raportimit në media.

Pas një procesi që synoi reduktimin e rrezikut me përfshirjen e disa agjencive qeveritare vendase, filloi një hetim nga rregullatori kombëtar i OJF-ve.

Nga hetimi u arrit në përfundimin se OJF-ja kishte procese jo të duhura për të vlerësuar përshtatshmërinë e folësve ose për organizimin e aktiviteteve.

Pas angazhimit të rregullatorit me OJF-në, OJF-ja ndërpreu aktivitetet e saj ndërsa drejtuesit ndërmorën një rishikim të plotë të rregullimeve të saj të qeverisjes.

Aktivitetet e OJF-së mbeten të pezulluara dhe OJF-ja po monitorohet nga rregullatori.

Rast Studimi

Mbështetje për Rekrutim

Një OJF e angazhuar në aktivitete kulturore, fetare dhe edukative tërhoqi vëmendjen e rregullatorit kombëtar të OJF-ve kur paraqiti qëllime të rishikuara për shqyrtim, siç kërkohet nga rregullatori.

Rregullatori vuri në dukje se qëllimet e reja të OJF-së u deklaruan në mënyrë të paqartë. Për më tepër, hulumtimi nga burime të hapura informacioni zbuloi se një nga drejtuesit kryesorë të OJF-së kishte bërë deklaratat dhe fjalime në mbështetje të veprimeve të dhunshme, promovonte rekrutimin me dhunë, dhe dehumanizimin e grupeve të tjera etnike dhe fetare. Gjithashtu, OJF-ja kishte pritur një folës që ishte përjashtuar nga aktivitete të tjera për shkak të fjalimeve dhe deklaratave të ngjashme. Kur u përball me këto shqetësime, OJF-ja rishikoi qëllimet e saj dhe deklaroi se drejtuesi dhe folësi nuk kishin më lidhje me OJF-në.

Si përgjigje, rregullatori auditoi OJF-në dhe lidhi një marrëveshje përputhshmërie që siguron llogaridhënie të rreptë operacionale dhe raportim.

Rast Studimi

Mbështetje për Rekrutim

Një OJF lokale e sapokrijuar dukej se organizonte dhe/ose mikpriste leksione që drejtoheshin ose ndiqeshin nga folës të njohur për promovimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Pas një procesi që synoi reduktimin e rrezikut me përfshirjen e agjencive të shumta qeveritare vendase, filloi një hetim nga rregullatori i kombëtar OJF-ve. Hetimi arriti në përfundimin se OJF-ja, në fakt, nuk i kishte organizuar vetë aktivitetet, por ishte e lidhur ngushtë me një institut arsimor jo-bamirës që kishte organizuar aktivitetet.

Rregullatori konstatoi se drejtuesit e OJF-së ishin njëkohësisht edhe drejtorë të institutit arsimor jo-bamirës.

UDHËZUES PRAKTIK

PËR ORGANIZATAT
JO-FITIMPRURËSE
(OJF)

2023

PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

RRUGA E ELBASANIT, PARK GATE BUILDING, KATI 10-TË,
AP. 71 / 73, KUTIA POSTARE 2418/1, 1010 TIRANË, SHQIPËRI

www.partnersalbania.org
partners@partnersalbania.org